



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 20/08**

**Prishtinë, më 04.09.2008, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Shkumbin Demaliaj dhe Behxhet Pacolli.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza, Behxhet Haliti, Zilif Luti nga MEF, Hysni Hoxha, Tefik Sylejmani nga OSHP, Fatmir Uka, Niman Zeneli, Fatmir Uka, Qerkin Morina nga Zyre e Auditorit të Jashtëm, Rrahman Zahiti nga DASHC/MSHP, monitruer nga Zyra e Presidencës, OSCE, NDI, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 24.07.2008;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të përkohshëm të buxhetit për gjashtëmuorin e vitit 2008.  
I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit Gjeneral nr. 351 për ri-shqyrtim të koeficienteve të aprovuara nga DASHC-sipas shkresës të datës 26.08.2008**

**Të ftuar: Përfaqësues nga Zyra e Auditorit Gjeneral;**

- 5. Shqyrtimi i kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për ndarjen e mjeteve për funksionimin e OSHP-së.**

**Të ftuar: Përfaqësues nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;**

- 6. Të ndryshme**

**6.1. Shqyrtimi i raporteve të mbetura:**

- **Shqyrtimi i raportit të institucionit të Ombudspersonit prej 1 korrikut 2007 – 30 qershor 2008;**
- **Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007.**

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

**Besa Gaxherri**, bëri vërejtje për njoftimin e vonshëm me rendin e ditës dhe me marrjen e materialeve të caktuara për shqyrtim në këtë rend dite. Si rezultat i kësaj, theksoi se nuk është sa duhet e përgatitur për diskutim, sidomos për pikën e tretë që ka të bëjë me raportin gjashtëmuor të buxhetit dhe pikën e gjashtë që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të AQBK-së për vitin 2007. Andaj propozoi që këto dy pika të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme.

**Safete Hadërgjonaj**, duke u ndërlidhur me propozimin e znj. Gaxherri, theksoi se ndihet e befasuar me propozimin e anëtares nga opozita për shtyrje të pikës së tretë, kur dihet se opozita vazhdimisht e ka kërkuar një raport të tillë për diskutim. Përndryshe materialet janë shpërndarë me kohë, andaj edhe nuk ka arsye që këto pika të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

**Haki Shatri**, duke u ndërlidhur me diskutimet, theksoi se shqyrtimi i raportit gjashtëmuor i buxhetit, është i përgatitur në përputhje me standardet e raportimit, mund të diskutohet lehtësisht dhe nuk ka nevojë për shtyrje. Ndërsa shqyrtimi i raportit vjetor të AQBK-së, për shkak të vëllimit të madh, mund të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

**Kosara Nikolić**, bëri vërejtje se nuk i ka marrë materialet për pikat e rendit të ditës në gjuhën serbe, andaj edhe nuk ka mundur të përgatitet për diskutim.

**Kryesuesi**, theksoi se materialet janë shpërndarë me kohë dhe nuk ka arsye për shtyrje. Duke i'u përgjigjur znj. Nikolic, tha se materiali është protokoluar në të tri gjuhët në të njëjtën ditë dhe i'u është shpërndarë me kohë deputetëve. Në vazhdim kryetari të kërkoi nga anëtarët të deklarohen me votim për propozimin e znj. Gaxherri për shtyrjen e pikës së tretë dhe të gjashtë të rendit të ditës për në mbledhjen e radhës.

Pas votimit të bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe një KUNDËR (znj.Besa Gaxheri), Komisioni nxori këtë:

### **P Ë R F U N D I M**

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

## 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 11 korrikut 2008

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se ka mjaftë gabime gjuhësore në procesverbal, ndërsa për nga përmbajtja është i hartuar mirë.

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt. 24 korrik 2008, u miratuan me vërejtjet e znj. Hadërgjonaj për përmisimin e gabimeve gjuhësore të tij.

## 3. Shqyrtimi i raportit të përkohshëm të buxhetit për gjashtëmuajorin e vitit 2008 I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa

**Kryesuesi**, duke komentuar pikën e tretë të rendit të ditës, theksoi se raporti gjashtëmuajor i buxhetit, në aspektin formal është mirë i përgatitur dhe konform standarteve të raportimit. Raporti si i tillë është i nivelit më të lartë në krahasim me raportet e viteve të kaluara, andaj edhe përgëzojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF-in) për këtë përparim të bërë. Për më tepër lidhur me këtë raport, kërkoi shpjegime nga përfaqësuesit e MEF-it.

**Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza**, theksoi se raporti gjashtëmuajor i buxhetit, është përgatitur konform standarteve për raportim. Nga të dhënat e pasqyruara në raport, shifet se gjatë gjashtëmuajorit të këtij viti, të hyrat kanë treguar performancë të mirë. Në strukturën e të hyrave, dominojnë të hyrat nga doganat, por performancë të mirë kanë treguar edhe të hyrat e realizuara, si në nivelin qendror po ashtu edhe në atë lokal. Të hyrat komunale janë 26.6% më të larta në krahasim me vitin paraprak. Më pas zv. ministri shpjegoi strukturën e të dalurave. Në kuadër të kësaj strukture nga kategoritë mallra dhe shërbime janë bërë kursime në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Sa i përket shpenzimeve në investimet kapitale, kemi ngecje në krahasim me ato të planifikuara, por janë realizuar 54% më shumë se në vitin paraprak. Një pasqyrë jo e favorshme është paraqitur te shpenzimet për lëndë djegëse, por kjo ka ndodhur si rezultat i ngritjes së çmimeve të këtyre derivateve. Gjithashtu kemi kursime në shpenzimet komunale. Numri i punëtorëve të shërbyesve civil është 395 më i ultë se në vitin paraprak. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, të hyrat kanë shënuar rritje 10%, ndërsa shpenzimet 18%, krahasuar me periudhën e vitit paraprak.

**Haki Shatri**, vlerësoi pozitivisht raportin, i cili i plotëson kriteret të bazuara në Ligj dhe standarde ndërkombëtare të raportimit. Z. Shatri konsideroi sukses përgatitjen dhe paraqitjen e raportit në këtë formë para Komisionit dhe Kuvendit, përkundër rrethanave që kanë ndikuar që Qeveria ka pasur vetëm katër muaj ta ekzekutojë buxheti e miratuar. Në vazhdim kërkoi dy sqarime. Çështja e parë ka të bëjë me atë se raporti a është mbështetur në buxhetin e aprovuar apo në buxhetin e rishikuar. Ndërsa çështja e dytë që intereso kishte të bënte me bashkëfinancimin e rrugëve. Pyeti se a janë evidentuar shumat, se sa ka financuar pushteti qendror, sa pushteti lokal dhe sa komuniteti në këto projekte. Përndryshe z. Shatri e përkrahu atë dhe kërkoi që Komisioni të dal me rekomandim për procedim të mëtutjeshëm të tij.

**Safete Hadërgjonaj**, përgëzojë Qeverinë dhe MEF-in për dorëzimin e raportit brenda afatit të caktuar ligjor. Raportin e vlerësoi më të përsosur teknikisht krahasuar me atë të viti paraprak. Shifet se ka një performancë të të hyrave, që kanë tejkaluar ato të planifikuara. Përshtypje lënë rritja e të hyrave të inkasuara nga Administrata Tatimore (të hyrat e brendshme), veçanërisht të hyrat e realizuara në Pjesën Veriore të vendit. Vlerësoi të suksesshëm punën e Qeverisë në kursimet e shumave për kategoritë mallra dhe shërbime, por konsideroi se ka hapësirë për të bërë edhe më shumë kufizime në këtë kategori. Megjithatë znj. Hadërgjonaj bëri vërejtje për disa investime kapitale që janë planifikuar për disa organizata buxhetore nuk shpenzohen që disa vite. Kërkoi që Qeveria t'i ketë parasysh gjatë buxhetit 2009, por edhe organizatat e tilla buxhetore të planifikojnë projektet që mund t'i realizojnë. Uroj që edhe raportet tjera të paraqiten me kohë dhe komisioni të ketë mundësi t'i diskutojë ato.

**Myrvete Pantina**, vlerësoi raportin përmbajtësor, me sqarime të nevojshme, i cili i plotëson kriteret e raportimit. Rritja e të hyrave paraqet një sukses. Megjithatë bëri vërejtje për mospërfshirjen e tabelës së shkurtesave në raport. Pastaj avanset e bëra në shumë të mëdha. Në veçanti u shpreh se e brengos fakti i paraqitjes së suficitit prej 78 milion eurove, si rezultat i mosrealizimit të shpenzimeve. Kërkoj një sqarim se çfarë është ulja e të hyrave nga kontrolla e jashtme doganore.

**Xhevdet Neziraj**, përgëzoi MEF-in për raportin e përgatitur mirë. Shifet se ka rritje të të hyrave dhe është vazhdimësi e rritjes së buxhetit për çdo vit, e që paraqet një sukses për të gjithë. Por në anën tjetër kemi edhe rritje të shpenzimeve. Bëri vërejtje për praninë e madhe të suficitit buxhetore dhe kjo si rezultat i asaj që Agjensionet buxhetore nuk kanë bërë planifikime të duhura të projekteve. Duke ditur nevojat e mëdha që ka vendi shfaqti shpresën se në fund të vitit, buxheti nuk do të përfundoj me suficit.

**Armend Zemaj**, vlerësoi pozitivisht raportin e përgatitur, sidomos suksesin në realizimin e shpenzimeve kapitale. Konsideroi sukses rritjen e të hyrave, por në anën tjetër edhe brengë të hyrat më të mëdha që ka realizuar Administrata Tatimore nga ekstra profiti. Kërkoj sqarime për ekzistimin e fondit rezervë të ministrit për statusin.

**Müfëra Şinik**, përgatitjen e raportit e vlerësoi si të suksesshëm në përgjithësi. Megjithatë investimet prej 45 % të pasqyruara në raport i konsideroi të paketa.

**Besa Gaxherri**, u pajtua për përparimin e bërë në hartimin e raportit në aspektin teknik. Potenco i se ka rritje të të hyrat që ka realizuar Administrata Tatimore, por në anën tjetër edhe shumë borxhe të pa inkasuara. Kritikoi Qeverinë për deklaratat e bëra për faljen e borxheve të organizatave publike, që kanë ndaj Administratës Tatimore. Sipas, znj.Gaxherri t'i falet KEK-ut borxhi është e papranueshme. Lidhur me kategorinë mallra dhe shërbime, nuk ka zbritje siq është pasqyruar në raport, ndërsa sa i përket shpenzimeve kapitale shifet se trendi është i njëjtë si vitin e kaluar. Sa i përket numrit të punëtorëve, te disa organizata buxhetore ka rënie, e të disa tjera ngritje, për këtë kërkoj sqarime. Duke ditur rëndësinë që ka raporti, krahasimet që do të duheshin analizuar, ndihet nevoja që Komisioni të punojë disa ditë.

**Haki Shatri**, lidhur me shpenzimet, kërkoj që mos të kritikohen ato vetëm si shifra, por të analizohet cilësia dhe dobia nga ato shpenzime.

**Hajdin Abazi**, vlerësoi raportin pozitivisht dhe të përgatitur sipas kriterëve për raportim. Duhet të kemi parasysh edhe ngjarjet që kanë ndodhur këtë gjashtëmuorë (krijimi i Ministrive të reja) dhe problemet në aspektin e shpenzimeve që kanë shkaktuar ato. Lidhur me zvogëlimin e numrit të punëtorëve të shërbyesve civil, pyeti përfaqësuesit e MEF-it, se çfarë do të bëhet në plotësimin e këtyre vendeve të punës, kur dihet numri i madh i të papunëve që ekziston.

**Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza**, në përgjigjen e pyetjeve të z. Shatri, theksoi se raporti është hartuar duke u bazuar në buxhetin e miratuar në muajin shkurt. Ndërsa sa i përket pyetjes për bashkëfinancimin e projekteve të rrugëve, ato janë bërë me participimin e përbashkët në mes përfaqësuesve të nivelit qendror, lokal dhe të komuniteteve. Në përgjigjen në pyetjet e znj. Pantina, premtoi se në raportin vjetor do të përfshihet tabela e shkurtesave, ndërsa sa i përket pyetjes lidhur me të hyrat nga kontrolla e jashtme doganore, tha se janë të hyrat që realizohen nga doganimi i mallit që bëhet jashtë pikave doganore (si rezultat i shmangies nga këto pika doganore). Në përgjigjen e pyetjeve të z. Zemaj, tha se të hyrat nga ekstra profit janë ato të hyra të realizuara nga Posta dhe Telekom i Kosovës, për shkak të monopolit që kishte në treg. Ndërsa fondi rezervë është përfshirë për shkak ka eksituar para miratimit të buxhetit. Duke i përgjigjur në pyetjen e znj. Gaxherri për gatishmërinë e Qeverisë për faljen e borxheve të kompanive publike që kanë ndaj Administratës Tatimore, theksoi se është diskutuar për faljen e ndëshkimeve e jo borxheve. Ndërsa në pyetjen e z. Abazi për numrin e punëtorëve të shërbyesve civil, arsyeja e mosplotësimit të vendeve të punës të atyre që janë larguar për motive subjektive, është

bërë për shkak të presionit që kemi nga institucionet financiare ndërkombëtare, për zvogëlim të këtij numri. Zv. Ministri, në përfundim theksoi se janë bërë kursimet në të gjitha kategoritë, ndërsa rritja e të hyrave prej 10%, ka ndodhur si rezultat i rritjes ekonomike, rritjes së inflacioni dhe administrimit më të mirë të politikës tatimore.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Zëvendëskryesuesi i parë konstatoi se Komisioni me nëntë vota PËR dhe një KUNDËR (Znj. Besa Gaxherri), nxori këtë:

## **R E K O M A N D I M**

I. Miratohet në parim Raporti i përkohshëm i buxhetit gjashtëmuor për vitin 2008 dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të njëjtin ta radhis në rend dite për shqyrtim në mbledhjen plenare.

**4. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit Gjeneral nr. 351 për ri-shqyrtim të koeficienteve të aprovuara nga DASHC-sipas shkresës të datës 26.08.2008**  
**Të ftuar: Përfaqësues nga Zyra e Auditorit Gjeneral**

**Kryesuesi**, lidhur më mos përmbushjen e kërkesës së Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ-së), nga ana e MEF-it, kryetari bëri vërejtje kësaj Ministrie, se disa herë nuk ka përfillur vendimet e Komisionit dhe Kuvendit dhe në këtë mënyrë nuk e ka zbatuar Ligjin. Prandaj kërkoi që të realizohet kërkesa e ZAGJ-së, në përputhje me vendimin për rishikimin e buxhetit dhe rekomandimit të Komisionit, në bazë të cilit MEF-i merr obligim të harmonizojë një kërkesë të tillë, e cila është edhe në përputhje me Ligjin e ZAGJ-së dhe Kushtetuten e vendit, sipas së cilit Kuvendi i'a lejon mjetet buxhetore, ndërsa Agjensioni në mënyrë të pavarur përcakton mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Më pas kryetari i'a dha fjalën përfaqësuesit të ZAGJ-së të shpjegoi arsyet e mosrealizimit të kërkesës së aprovuar.

**Qerkin Morina**, arsyetoi kërkesën që i është bërë MEF-it, konform Ligjit të buxhetit të rishikuar, i cili ka aprovuar këtë kërkesë për transferimin e mjeteve të brendshme. Përgjigjen që kanë marrë nga ata ka qenë se problemi e koeficineteve duhet të zgjidhur nga Ministria e shërbimeve Publike(MSHP), e cila ka me vendimin e saj ka vepruar jo në pajtim Ligjin për rishikimin e buxhetit të aprovuar.

**Rrahman Zahiti**, theksoi se kërkesën e kanë shqyrtuar në bashkëpunim me MEF-in dhe përgjigja e MSHP-së ka qenë konform bazës ligjore. Në bazë të kësaj nuk është lejuar të ketë koeficient më të lartë se sa e parasheh Rregullorja për Shërbyesit Civil, më përjashtim të disa rasteve specifike.

**Safete Hadërgjonaj**, lidhur me kërkesën në fjalë, theksoi se rekomandimi i Komisionit ka qenë të gjindet baza ligjore për realizimin e një kërkesë të këtillë. Ndërsa Komisioni ka qenë kundër koeficienteve të paraqitur në kërkesë, sepse është në kundërshtim me Rregollren për Shërbyesit Civil, e cila rregullon këto çështje. Duke u ndërlidhur me ndryshimet që janë bërë, tha se Kushtetua përcakton pavarësinë financiare të ZAGJ-së, për ajo ka edhe kufizime. Në këtë drejtim kërkoi që para miratimi të buxhetit 2009, të përcaktohet drejtë baza ligjore e koeficienteve të pagave për të gjithë shërbyesit civil, të të gjitha Agjensioneve buxhetore, në mënyrë që të mos paraqiten më probleme të kësaj natyre.

**Fatmir Uka**, duke u ndërlidhur me përcaktimin e koeficienteve, theksoi se Kushtetuta i garanton menaxhmentit të Zyrës, që në mënyrë të pavarur të përcaktojë ato.

**Armend Zemaj**, kujtoi përkrahjen e madhe që ka marrë kjo Zyrë nga Komisioni, me rastin e shqyrtimit të kërkesave të saja, për shkak të rëndësisë së punëve që kryen ajo. Prandaj edhe kritikoi përfaqësuesit e ZAGJ-së, të cilët ka qenë dashur të mendojnë për zgjidhjen e problemit të pagave të punëtorëve të saj

edhe për vitin tjetër, ashtu siç ka rekomanduar Komisioni. Kjo do të mund të realizohet duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

**Hajdin Abazi**, po ashtu konfirmojë përkrahjen që i ka dhënë Komisioni këtij Agjensioni duke ditur rëndësinë e punëve që kryen ai. Prandaj si rezultat i kësaj kërkoi të gjindet zgjidhja e kërkesës parashtruar, duke respektuar bazën ligjore për përcaktimin e koeficienteve për shërbyesit civil. Në këtë drejtim z.Abazi kërkoi të krijohen standardet ligjore që do të jenë të aplikueshme për të gjithë Agjensionet buxhetore. Për t'u sqaruar dhe më qëllim të krijimit të terminologjisë unike, pyeti se si quhet Organi i parashtruesit të kërkesës, duke pasur parasysh faktin se egzistojnë tre emra për këtë.

**Niman Zeneli**, theksoi se arsyeja e zgjidhjes në formë të koeficienteve, ka qenë për shkak të ruajtjes së punëtorëve të kualifikuar, të cilët ikin me arsyetimin e pagës së ulët. Në këtë drejtim kërkoi të mos bëhen pengesa financiare në mënyrë që Agjensioni të mund të kryej punën e vet dhe puna e tij të pranohet ndërkombëtarisht.

**Besa Gaxherri** duke ditur rëndësinë e këtij Agjensioni, dhe duke pasur parasysh rekomandimin e Komisionit lidhur me këtë kërkesë, znj.Gaxherri kërkoi nga MEF-i, të gjinden modalitetet për realizimin e kësaj kërkese, ashtu siq është miratuar edhe Ligjin për buxhetin e rishikuar. Ndërsa vitin e ardhshëm të definohet qartë buxheti i kësaj Zyre dhe sipas mundësisë të stimulohet ai në mënyrë që mbështetet puna e rëndësishme që kryen ky Agjension.

**Haki Shatri**, përkundër miratimit të kësaj kërkese, kërkoi që ashtu sikurse edhe për Agjensionet tjera kushtetuese, të respektohen kriteret për caktimin e koeficienteve për shërbyesit civil, të cilën gjë e bën MSHP-ja e jo Komisioni. Prandaj për realizimin e mjeteve të gjenden modalitetet, duke respektuar standardet ligjore për përcaktimin e pagave.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR , nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni shqyrtoi kërkesën nr. 351 e Zyrës së Auditorit Gjeneral dhe duke u mbështetur në kërkesën e aprovuar nr. 03/0869/Do-507 dt. 21.07.2008 të Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës për rishikimin gjashtëmuor të buxhetit 2008 për Zyrën e Auditorit Gjeneral të Kosovës, i rekomandon Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë së Shërbimeve Publik të veprohet në bazë të Ligjit për ndryshimet e Ligjit nr. 03L-088 për miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuar për periudhën janar deri më 31 dhjetor 2008, dhe rekomandimeve të Komisionit për këtë çështje.

5. **Shqyrtimi i kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për ndarjen e mjeteve për funksionimin e OSHP-së.**

**Të ftuar: Përfaqësues nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;**

**Kryesuesi**, duke u thirrur në vendimin e Kuvendit për themelimin e këtij organi, kërkoi që kërkesa e OSHP-së për ndarjen e mjeteve për funksionimin e tij të miratohet. Më pas hapi diskutimin.

**Zv.ministri i Ekonomisë dhe Financave z. Bedri Hamza**, theksoi se nuk është në dijeni për një kërkesë të tillë të jetë parashtruar në MEF. I ftoi përfaqësuesit e këtij organi që të njëjtën kërkesë të paraqesin pranë Departamentit të Buxhetit (MEF), në mënyrë konform procedurave ligjore të shqyrtohet dhe të merret një vendim për të, pastaj të mund të kalojë për shqyrtim në Komision dhe Kuvend.

**Safete Hadërgjonaj**, u pajtua me zv.ministri rreth respektimit të procedurave për parashtrimin e kërkesave buxhetore nga organizatat buxhetore. Paraprakisht është dashur të kemi një shkresë nga MEF-i, lidhur me kërkesën në fjalë. Përndryshe në mungesë të sqarimeve të nevojshme, kjo kërkesë nuk duhet të kalojë. Prandaj i rekomandoi përfaqësuesve të OSHP-së të parashtrojë kërkesën e kompletuar në MEF, dhe më pas me një procedurë të përsheptuar të kalojë në Komision, e më pas me në Kuvend.

**Haki Shatri**, u pajtua me parafolësit, që kërkesa duhet të kalojë përmes MEF-it, e cila duhet të i'a bashkangjitet një shkresë që arsyeton atë.

**Hysni Hoxha**, njoftoi anëtarët se kërkesa është parashtruar në MEF. Hartimi i shkresës është bërë sipas propozimit të MEF-it, dhe për fillim kemi kërkuar hapjen e një linje buxhetore. Por përfaqësuesit e ministrisë, na ka adresuar që të njëjtën të parashtrojmë në këtë Komision.

**Armend Zemaj**, theksoi se si të tillë kërkesën nuk mund të miratojmë, sepse nuk ka arsye ligjore. E vetmja që mund të bëjmë të japim rekomandimin se duhet hapur linjën buxhetore për këtë organ.

**Besa Gaxherri**, kërkoi që për shkaqe teknike dhe procedurale të mos pengohet funksionimi i punës së këtij organi të pavarur. Pengesat e paraqitura janë si rezultat i tendencës së Qeverisë për të bërë atë të varur. Si Komision të merret një rekomandim me të cilin kërkohet që brenda një kohe të caktuar të zgjidhet problemi dhe t'i mundësohet Agjensionit fillimi i funksionimit.

**Kryesuesi**, u shpreh kritik ndaj MEF-it, i cili nuk respekton vendimet e plotfuqishme të Komisionit. Duke kuptuar situatën aktuale, rekomandoi që kërkesa të përsëritet për shqyrtim në MEF (Dep.Buxhetit) dhe ministria, të shqyrtoj atë dhe brenda shtatë dite të marr një vendim.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR , nxori këtë:

### **Kërkesë me rekomandim**

- I. Kërkesa e Organit për shqyrtimin e prokurimeve, lidhur me ndarjen e mjeteve buxhetore për funksionim, nr.03/932/Do-561, dt. 02.09.2008, i dërgohet në shqyrtim Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, në përputhje me nenin 94.3 të Ligjit nr.02/L-99 mbi prokurimet publike në Kosovë si dhe nenin 20.2 (a,b,c,d,e) të Ligjit nr. 03/L-48 mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- II. Pas marrjes së rekomandimeve të MEF-it lidhur me ndarjet, dhe në përputhje me nenin 20.2 (i) të Ligjit në fuqi, Komisioni për buxhet dhe Financa, do të shqyrtojwë dhe do të rekomandojë miratimin e të njëjtës.

## **6. Të ndryshme**

### **6.2. Shqyrtimi i raporteve të mbetura:**

- Shqyrtimi i raportit të institucionit të Ombudspersonit prej 1 korrikut 2007 – 30 qershor 2008;
- Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007.

**Kryesuesi**, theksoi se duke ditur faktin se këto raporte janë paraqitur pas afateve ligjore për raportim dhe ditur rrethanat e një vonese të këtillë, me qëllim i ka futur në pikën të ndryshme, në mënyrë që Komisioni të merr qëndrim se si të trajtohen ato.

**Hajdin Abazi**, theksoi se raportit të Ombudspersonit i mungon pjesa financiare dhe si i tillë nuk mund të jetë objekt diskutimi nga Komisioni. Kjo mund të bëhet pas plotësimit me pasqyrat financiare.

**Kryesuesi**, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit, tha se raporti si i tillë në mungesë të pjesës financiare është dashur të adresohet në Komisioni funksional të Kuvendit, prandaj ashtu siç është përgatitur nuk mund të jetë objekt trajtimi nga Komisioni ynë.

**Safete Hadërgjonaj**, kërkoi t'i bëhet një vërejtje për plotësim të raportit me pasqyrën financiare, e cila tregon mënyrën e shpenzimit të mjeteve të këtij Agjension për vitin 2007. Edhe pse raportimi për këtë institucion është përfshirë në kuadër të raportit të buxhetit, plotësimi i tij do të ofronte informacione të cilat do të shërbenin me rastin e shqyrtimit të kërkesës buxhetore këtij Agjensionit për vitin pasues.

**Haki Shatri**, raporti i Ombudspersonit është futur në kuadër të raportin vjetor të buxhetit, i cili është miratuar në Komision, prandaj theksoi se nuk ka nevojë të jetë objekt shqyrtimi.

**Besa Gaxherri**, duke u ndërlidhur me temën, theksoi se megjithatë, Komisionin e obligon Ligji për shqyrtimin e këtyre raporteve dhe dhënien e arsytetimeve të tyre në Kuvend.

**Safete Hadërgjonaj**, sa i përket raportit të AQBK-së, e ka analizuar dhe ka vërejtur se ai është i përgatitur mirë dhe i detalizuar. Arsye pse është paraqitur me vonesë janë të njohura, për shkak të ndryshimit të rregullatave ligjore dhe pavarësisë së këtij agjensionit. Përndryshe znj. Hadërgjonaj theksoi se ia vlen për tu diskutuar në Komision, për shkak të përshtypjeve të mira që i ka lënë ai për nga mënyra e hartimit dhe prezantimit të gjërave.

**Haki Shatri**, lidhur me raportin e AQBK-së, theksoi se është përgatitur në kohën kur Bordi i AQBK-së ka qenë nën autoritetin e PSSP-së dhe është miratuar nga ai. Andaj ajo qka mund të bëjë Komisioni, t'i rekomandoj kryesisht ta fus në rend dite për këtë vit, ndërsa viteve tjera të kalojë përmes Komisionit.

**Kryesuesi**, pasi që raporti është futur në procedurë, propozojë që të shtyhet për në mbledhjen e radhës, të ftohen përfaqësuesit e AQBK-së dhe si Komision të marrim një qëndrim.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me dhjetë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, nxori këtë:

### **Q ë n d r i m**

- I. Raporti i vjetor i Ombudspersonit është i paplotësuar me pasqyrat financiare dhe si i tillë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i Komisioni.
- II. Me qëllim të respektimit të procedurave ligjore për raportim të Agjensioneve buxhetore dhe marrjes së informacioneve më të hollësishme nga përfaqësuesit e AQBK-së, raporti i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për vitin 2007 shtyhet për diskutim në mbledhjen e radhës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30

**Kryesuesi i Komisionit**

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

---

**Gani KOCI**